



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 55, datë 10.04.2020

PËR
KONTRIBUTIN NË FONDIN ANTI COVID-19 TË NJË PJESE TË PAGËS DHE
SHPËRBLIMIT TË DISA FUNKSIONARËVE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 11, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Në kuadrin e masave për të lehtësuar përballimin e situatës së pandemisë, krijuar nga koronavirusi COVID-19, në shenjë solidariteti me qytetarët dhe bizneset e prekur nga masat ndaluese të koronavirusit, në përgjigje të shkresës nr. 1053 prot. të Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi “Mbi kontributin financiar për lehtësimin e përballimit të situatës së pandemisë COVID-19, nëpërmjet përgjysmimit të pagave për drejtuesit e lartë”, si dhe në linjë me Vendimin nr. 243, datë 24.03.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit nr. 4, datë 30.03.2020, të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile “Për trajtimin e përkohshëm të trajtimit financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore”, si kontribut në lehtësimin e përballimit të nevojave për parandalimin e përhapjes së këtij virusi të rrezikshëm dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19,

V E N D O S I:

- 1. Kryetari i Bordit dhe anëtarët e tjerë të Bordit të kontribuojnë në masën 50% të shpërblimit mujor neto, në fondin anti COVID-19, për muajt prill, maj dhe qershor 2020.**
- 2. AMF të derdhë në fondin anti COVID-19, 50% të pagës neto të llogaritur për Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Nëndrejtorin Ekzekutiv, për periudhën prill, maj, qershor 2020.**

3. AMF të derdhë në fondin anti COVID-19, kontributin në masën 30% të pagës neto për Drejtorët e Departamenteve për muajin prill 2020.
4. Ky kontribut, të derdhet në llogarinë e përcaktuar të fondit anti COVID-19.
5. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ervin METE _____ KRYETAR

Idlir GJATA _____ ANËTAR

Deniz DERALLA _____ ANËTAR